
bjoerna.dk [Bjoern Andersen, sociologist](mailto:Bjoern.Andersen.sociologist@post.bjoerna.dk) post@bjoerna.dk

Vajza shqiptare dhe artistët danezë

Version 1.2 - 24.04.2006 [version 1.0 in [English](#) published 26.09.2005]. - PDF: <http://bjoerna.net/albania/vajza.pdf>



Vajza shqiptare?, vajza italiane?. Albert Küchler, 1831

Kohët e fundit profesor Ferid Hudhri ka shtruar disa ide rreth pikturës së një vajze shqiptare e cila tani gjendet në Glyptoteket, një muze me reputacion në Kopenhagen, Danimarkë. Almira Pajenga nga Ambasada Daneze në Tiranë, më bëri të mundur që të njihem me idetë të cilat janë paraqitur në revistën »Klan« dhe gazetën »Tema«.

Në shumë libra rreth artit dhe letërsisë daneze piktura e mirënjohur është quajtur *vajza shqiptare* - në libra të tjerë *vajza italiane*. Profesor Hudhri pyet nëse vajza në të vërtetë ishte me origjinë shqiptare apo nëse ka ndonjë shpjegim tjetër, - ndoshta vajza ishte një italiane nga kodrat Albani në jug të Romës. Vetë profesor Hudhri sygjeron se ajo kishte origjinë shqiptare dhe ishte e vendosur në Romë. Ka mundësi - shton ai - që ajo vizitoi një familje të rëndësishme shqiptare në Romë e cila shpesh organizonte mbledhje me pjesëmarrjen e artistëve.

Disa gjëra mund të thuhën me siguri, disa të tjera nuk mund të vendosen kaq lehtë.



Professor Ferid Hudhri, TV Teuta, 2006

Në Korrik-Gusht të këtij viti [2005] unë bëra një studim të shkurtër rreth pikturës dhe personat që kanë të bëjnë me të. (Studimi mund të gjendet në danisht në faqen e internetit: <http://bjoerna.net/albanerinden/>).

Piktura ishte bërë nga artisti danez Albert Küchler, një murg i mëvonshëm, kur bashkëfshatari i tij, poeti Christian Winther bëri një vizitë në Romë në vitin 1831. Se kush në fakt takoi vajzën për herë të parë - Küchler apo Winther – nuk dihet, më tepër ka mundësi të ishte Küchler.

Në atë kohë, shumë artistë dhe poetë danezë vizituan Romën dhe udhëtuan nëpër Itali, midis tyre dhe Bertel Thorvaldsen, skulptor dhe H.C. Andersen, autor i përrallave. Shpesh këta danezë takonin njëri tjetrin në taverna dhe herë pas here ata vizitonin rrethinat e Romës. Një nga drejtimet më të rëndësishme ishte zona Nemi në kodrat Albani. Akademia Daneze në Romë, ka shumë informacion rreth danezëve dhe zonës Nemi.

Ashtu siç e shtron profesor Hudhri, vajza mund të ketë qenë nga fshatrat Arbëreshe në Jug të Italisë, por më duhet të pajtohem me të kur ai e gjykon këtë jo si shumë të mundshme. Ka disa shpjegime. Përpara së gjithash largësia e madhe, së dyti traditat e familjes shqiptare nuk do të mund të përkonin kaq lehtësisht me një jetesë si »një grua e lirë« dhe një e dashur e një poeti danez.

Marrëdhënia midis bukurisë së re dhe poetit ka qenë shumë intensive dhe ka mundësi që vajza të ketë pretenduar se ishte shtatzënë kur poeti u kthye në Danimarkë – vetëm për të përfshirë veten e tij në lidhje erotike më intensive. Së fundi ai i dha asaj kur u nis një *vigne* – një vreshtë të vogël.

Pak kohë më vonë, kur Winther mbërriti në veri të Italisë, ai i shkroi një prej miqve të tij, skulptorit Bissen:

»Më duhet t'ju kërkoj të vizitoni djallin e vogël dhe t'i lexoni asaj një letër. Mund t'ja kërkoja djemve të tjerë, por ju do të ishit korrieri më i mirë i dashurisë, përderisa Küchler nuk ndodhet – dhe në fakt nuk më pëlqen që dashuria ime të dalë në pazar.«

Ne dimë që Winther – të paktën në këtë kohë- nuk dinte mirë italisht. Ka mundësi që ai t'i

ketë shkruar vajzës nëpërmjet Bissenit në Danisht, dhe më pas korrierit iu desh tia lexonte letrën asaj në Italisht. Mbase ajo ishte edhe analfabete?

Përsa dimë sot, Winther i humbi shpejt kontaktet me vajzën. Për më tej ne nuk kemi njohuri rreth ripërtëritjes së kontaktit midis tyre në kohën kur Winther shumë vite më pas vizitoi Romën, këtë herë me gruan dhe vajzën e saj nga një martesë e mëparshme.

Në fakt, Wintheri e pati pikturën në dorë për disa vite, por – sipas disa burimeve atij iu desh ta shiste atë në një periudhë krize. Një arsye tjetër se pse ai hoqi dorë nga ajo mund të ketë qenë xhelozia e të dashurës së tij në atë kohë. Disa vite më vonë piktura u morr nga Glyptoteket.

Kam qenë në kontakt me njerëz që kanë njohuri rreth artistëve danezë në Romë dhe veçanërisht rreth Albert Küchlerit. Kam kaluar shumë herë nëpër duar letrat e Christian Wintherit, biografisë më të madhe të Wintherit (nga Nikolaj Boegh), disa artikuj rreth piktorit, paragrafet përkatëse në Alberto Crielesi's *»Il pittore Fra PIETRO da COPENAGHEN al secolo ALBERT KÜCHLER. Quando la Povertà con l'Arte diventa Poesia«* (Roma 1999) – dhe disa artikuj në një revistë daneze nga shekulli 19-të rreth Küchlerit dhe Wintherit.

Në asnjë nga këto letra, libra, artikuj etj. nuk është sygjerruar që vajza duhet të ketë qenë me origjinë shqiptare (në kuptimin tonë të fjalës). Dhe njerëzit me të cilët kam qenë në kontakt kanë të njëjtin mendim si unë – midis tyre autorët danezë Per Nyholm dhe Stig Holsting.

Më tej, Alberto Crielesi shkruan se rrobat e vajzës janë nga kodrat Albani.

Duhet shtuar se ishte shumë e zakonshme midis artistëve danezë të asaj kohe që t'i quanin njerëzit nga kodrat Albani si Albanians; ka shumë evidenca për këtë. Vetëm specialistët, të paktën arkeologu dhe filologu Peter Oluf Broendsted, i cili vizitoi Ali Pash Tepelenën, veçoi ndryshe. Në pjesën e parë të shekullit të 20-të fjala »Albanian« më shpesh u përdor me kuptimin e sotëm – psh. nga filologu Holger Pedersen dhe autori Franz von Jessen, të cilët vizituan zonën shqiptare dhe u hoq dorë nga kuptimi i vjetër. Meqë ra fjala, nëse vajza do të ishte me origjinë shqiptare, unë do të mendoja se ajo do ta quante veten një Arbëresh, jo një Albanian.

»Fatkeqësisht« ne nuk mund të provojmë se bukuria kishte origjinë Shqiptare gjithsesi diskutimi na ka dhënë një mundësi shumë të mirë në Danimarkë për të rritur vëmendjen ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve në shekullin e 19-të.

Shpresojmë që në të ardhmen të gjejmë më shumë lidhje që nga ajo kohë dhe nga periudha të tjera për të hulumtuar më hollësisht.

Translation from English: Almira Pajenga

»Revista Klan«: <http://www.revistaklan.com/material.php?id=346>

»Zëri yt«. Tribuna ë fjalës së lirë: <http://www.forumi.zeriyt.com/index.php/topic,16482.0.html>

»Radio Focus Tetovë«: <http://focus.tetova.de/modules/news/article.php?storyid=244>

Bjoern Andersen ka Master në filologji dhe sociologji Daneze. Ai ka vizituar Shqipërinë disa herë gjatë viteve, për herë të parë në 1976. Në 2003 dhe 2004 ai ishte pjesëmarrës në konferencat rreth »ndeshjes së civilizimit dhe tolerancës fetare«, në Tiranë. Ai është autor i disa librave rreth historisë shqiptare në Danisht.

Kohët e fundit ai ka publikuar »*Ligji Danez i vitit 1683*« në një botim dixhital – dhe tashmë ai është duke punuar mbi një libër rreth autorit Danezo-Norvegjez Ludvig Holberg – i cili, në 1739, shkroi një artikull vlerësimi për Skënderbeun.
